



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1160/1 prot.

Tepelenë, më 23.05. 2022

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tepelenë.

KËSHILLTARËVE TË BASHKISË

Sheshi “Lord Bajron”, Tepelenë.

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË Z. TËRMET PEÇI

Sheshi “Lord Bajron”, Tepelenë.

Të nderuar Këshilltarë,

Ju njoftoj se ditën e martë më datë 31.05.2022, ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Tepelenë (kati i dytë) do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të, Pikës 4, Neni 53 i Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, me rend dite si vijon:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi vendimet e Këshillit Bashkiak të mbledhjes së muajit Prill datë 28.04.2022.
3. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë 28.04.2022.
4. **Projektvendim** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Prill 2022”.
5. **Projektvendim** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Prill 2022”.

6. **Projektvendim** “Për miratimin e raportit për monitorimin e vlerësimin e buxhetit për periudhën 4 mujori i parë 2022”.
7. **Projektvendim** “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.76, datë 17.12.2021 ”Për miratimin e buxhetit të vitit 2022”.
8. **Projektvendim** “Për pjesëmarrjen e Bashkisë Tepelenë në subjekte me kompetenca të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura”.
9. **Projektvendim** “Për përfundim procedure privatizim banese shtetërore”.
10. **Projektvendim** “Për miratim të kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinise si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij”
11. **Projektvendim** “Për azhurnimin e segmentit rrugor dhe i pasurive nr.: 1090, 1034, 1036, 1045, 288, 296, Zona Kadastrale nr. 2807 dhe nr. 3177, ndodhur në, fshatin Nivicë dhe fshatin Rexhinë, Njësia Administrative Kurvelesh”.
12. Çështje të tjera.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Elvis Shehu

MBLEDHJET E KOMISIONEVE

Datë 30 Maj 2022

- **Komisioni i Ekonomisë dhe Kryetarët e Komisioneve**, ditën e hënë, datë 30.05.2022, ora 12:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Tepelenë, do të shqyrtojë pikat 4, 5, 6, 7, 8, 9, të rendit të ditës.
- **Komisioni Arsim – Kulturës dhe dhënies së titujve të nderit**, ditën e hënë datë 30.05.2022, ora 12:30, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Tepelenë do të shqyrtojë pikën 10 të rendit të ditës.